

Jam njeri i pashëm, i shëndoshë dhe i gjatë. I pari i familjes së Beni Eshhelit, përndryshe i takoj fisit Evs. Si musliman jetova vetëm gjashtë vite, sepse pranova Islamin pasi i kisha kaluar të tridhjetë e njëjtat. Rashë dëshmor në moshën tridhjetë e shtatë vjeçare.

E kam dëgjuar Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem duke thënë se, për vdekjen time është dridhur Arshi, dhe e kishin përcjellë kufomën time shtatëdhjetë mijë melaqe.

Vërej se jeni kureshtarë që të më njihni. Pra, po u rrëfej për jetën time.

Në kohërat e lashta fisi im jetonte në Jemen. Pas shkatërrimit të pendës Metreb, vërshimet shkatërruan të gjitha arat dhe fushat. Uji fundosi të gjitha kasollat dhe pallatet. Fisit tim si mbeti gjë tjetër, pos të shpërngulet dhe të ikë nga uria dhe etja. Ashtu, u përqëndrua në Hixhaz, ose më saktë, në qytetin Jethrib (që pas hixhretit do të quhet Medinë Munevere). Gjyshërit e mi jetuan në Medinë, së bashku me fisin Hazrexh. Evisi dhe Hazrexhi atë kohë ishin në armiqësi. Çdonjëri dëshironte ta sundojë tjetrin. Poashtu, në Jethrib jetonin çifutët Beni Nadir dhe Beni Kurrejdha.

Shumë mirë më kujtohet dita, kur dëgjova se në Mekke ishte paraqitur një njeri që e quanin Muhammed Ibën Abdullah. Ai predikonte një fe të re, por unë atëbotë kisha vetëm njëzet vjet, andaj nuk më interesoi shumë kjo gjë.

Në Medinë ditët kalonin si rëndom. Një ditë, kur unë i kisha të tridhjetë e catat, dëgjova se një delegacion nga Medina ishte takuar në Mekke me Pejgamberin e ri, dhe para tij kishin deklaruar Islamin. Ata kishin marrë me vete një misionar, të cilin e quanin Musab ibën Umejri. Ai muslimanëve të Medinës u lexonte Kur'an, dhe i mësonte gjëra që kishin të bëjnë me fenë Islame. Në ndërkohë, i thërriste medinasit që të hynë në fenë e re - ISLAME.

Nuk mund ta paramendoni sa u mllëfosa unë, por edhe medinasit tjerë, kur dëgjuam për atë njeri që e kishte dërguar Muhammedin, që të na e trazon jetën tonë. Qëllimi i tij ishte të na e ndërrojë fenë e etërve tanë të parë. Kishte edhe diç tjetër, që më bezdiste edhe më shumë! Musab ibën Umejri banonte në shtëpinë e kusheririt tim, Esad ibën Zurades! Në fjalë, shtëpia e Esadit ishte bërë qendër e tubimeve, në të cilat Musabi ushtronte misionin e tij.

Nuk munda të pres. Mora armët, dhe u drejtova kah shtëpia e Esadit. E pashë të domosdoshme ta largoj atë të huaj nga Medina, me gjithë fenë e tij, e nëse e kërkon nevoja, ta mbysë. Arrita në shtëpinë e kusheririt, kur ja, Musabi ishte ulur në mes të disa muslimanëve dhe lexonte Kur'an. Unë e ndërpreva, ashtu që filloi një dialog i rreptë mes nesh. Për habi, ai gjithnjë

fliste buzëqeshur, dhe ishte i butë. Më tha: "O filan, të lutem ulu, dhe më lejo të të flasë për fenë Islame! Dëgjoje Kur'anin, që i është zbritur Muhammed Mustafasë, e pastaj gjyko."

Pse ta fshehi të vërtetën. Fjalimi i Musabit ndikoi shumë në mua. Thashë në vehte: ta dëgjoj këtë njeri çdo të thotë, dhe u ula. Gjersa fliste, në fytyrën e tij dukej një fuqi. Kur lexonte Kur'an, i shndriste fytyra. Unë isha i qetësuar, por disi një frikë më trondiste. Besoni, kurrë më parë nuk jam ndier ashtu. Hudha një vështrim rreth meje, dhe vëreja fytyra që ndriçonin. Ato ishin fytyrat më fatlume që ndonjëherë i kisha parë. Fjalët e Musabit ishin me vend, dhe e gjeta të vërtetën, (të vërtetën) e pa shoq.

Ende pa e përfunduar ai fjalën, iu afrova pranë, i zgjata dorën, dhe thashë: "Dëshmoj se All-llahu është Një dhe Muhammed sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem është Pejgamber i Tij." Të pranishmit thonin shehadetin dhe thirrnin tekbiere. Mu afrua djali i tezës, e me përqafoi vëllezërisht, duke më uruar fenë Islame.

Menjëherë vajta te familja ime, Beni Abdul Eshhel. U thashë: "Ç'mendoni për mua?" E ata më thanë: "Ti je më i mirë dhe më i mençur se të gjithë." U thashë: "Kam dëgjuar diç prej Musabit, që do të ishte zgjidhje për çështjen tonë, prandaj i besova fjalëve të tij dhe u bëra musliman. U them se, pas këtij momenti, nuk do të flas me ju, derisa ta pranoni fenë islame."

A e dini ç'ndodhi pastaj? E gjithë familja ime pranuan fenë, dhe unë fillova t'i ndihmoj Musabit në kryerjen e misionit të daves. Ashtu që, shumë medinas dhe fise, që pranuan Islamin para meje, thonin se isha shumë i dobishëm për ta në zgjerimin e fesë islame.

A ka më mirë se të jesh musliman. Çdo ditë të sjell gëzim dhe lumturi. Por, dita kur u vendos në Medinë Muhammed sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe shpëtoi nga torturat e pabesimtarëve mekkas, ishte gëzim i madh për besimtarët. Shtëpitë e të gjithë medinasve ishin të hapura për vëllezërit e tyre muhaxhirë. Gjithë pasurinë tonë ia falëm Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe fesë Islame.

Një ditë, Muhammed sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem i tuboi vendasit dhe muhaxhirët, që të konsultohet për çështjen e luftës kundër mushrikëve. U drejtua dhe tha: "Ç'thoni ju o burra?" U ngrita në këmbë, dhe iu drejtova atij: "Siç duket, ti e dëshiron mendimin tonë?"

"Po", u përgjigj Muhammed sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Unë shtova: "O i Dërguar i Zotit të Madhëruar, ne të kemi besuar dhe kemi dëshmuar se Kur'ani është libri i Zotit. O Pejgamber, ty të kemi dhënë besën, prandaj vepro si të duash, se ne jemi me ty. Pasha Atë që të ka dërguar, sikur t'i lëshohesh detit, ne do të

vinim pas teje, e askush nga ne nuk do të tërhiqej. Ne dëshirojmë të luftojmë ballë për ballë me armikun. Ne jemi durimtarë në luftë, e që edhe vet do të bindesh. Na udhëzo kah takimi i All-llahut të Madhëruar."

Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem u gëzua shumë nga këto fjalë, dhe tha: "Ecni dhe përgëzoni, se Zoti i Madhëruar më ka premtuar fitoren. Unë po i shoh kufomat e mushrikëve..." I luftuam mushrikët në Bedër, e pastaj në Uhud. Në të dy luftërat isha si ushtarë, dhe gjithmonë afër Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Pas këtyre dy luftërave, u kthyem në Medinë, dhe, si zakonisht, vazhduam të bëjmë ibadet, të këshillojmë njëri-tjetrin, të ndihmohemi mes vete, dhe mësonim gjëra të reja prej Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Por urrejtja ndaj nesh dita-ditës rritej në zemrat e çifutëve dhe mushrikëve. Atyre u pengonte paqja dhe rregullat e shtetit Islamik.

Ata vërenin se dita-ditës numri i muslimanëve është duke u shtuar, e kjo te ata shkaktonte frikë se një ditë do ta humbin fuqinë dhe autoritetin.

Një ditë, një grup çifutësh u drejtuan për në Mekke, me qëllim që t'i nxisin mekkasit për luftë kundër muslimanëve. Në fjalë, ata shprehën mendimin për vrasjen e Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, se vetëm në këtë mënyrë do të mund ta shuajnë misionin e tij. Dhe lidhën kontratë me kurejshin, që të përgatiten për luftë, në mënyrë që kur kurejshin të nisen për në Medinë, aty t'ju bashkangjiten atyre aleatët çifut.

Shpejt arriti lajmi te Muhammed sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ky menjëherë urdhëroi muslimanët që të përgatiten. Selman Farisiu propozoi planin e Hendekut, me qëllim që të pengohet ushtria pabesimtare që të hyjë në Medinë.

Mua më dërgoi, në krye të një delegacioni, te fisi Beni Kurejdha, që të njihem me qëndrimin e tyre në këtë rast. Unë ua përkujtova atyre paqen të cilën e kishin nënshkruar, por ata hap-tazi shprehën urrejtjen ndaj muslimanëve dhe Islamit, duke thënë se nuk duan kurrfarë paqe me Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Si zakonisht, edhe kësaj rradhe çifutët na tradhtuan. Aq u zemërova në ta, sa që desha ta nxjerr shpatën, e të më mbajnë në mend. Por, Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem nuk kërkonte një gjë të tillë, kështu që u kthyem dhe e lajmëruam Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem për tradhëtinë e tyre.

Ushtria kurejshite hasi në kanalin e gropuar, e prapa tij ishim ne muslimanët, që mbroheshim. Ashtu që, nuk ju mbeti gjë tjetër, pos të përqëndroheshin rreth Medines.

A e dini kur ndodhi kjo? Dhe, sa numëronte ushtria jonë, e sa ajo e kurejshiteve?

Kjo ndodhi në muajin sheval të vitit të pestë të hixhretit. Ushtria e tyre numëronte më tepër se dhjetë mijë veta, kurse ne ishim vetëm tremijë muhajedinë. Në radhët e para të muslimanëve u gjinda unë. Detyra jonë ishte që mos të lejojmë që ushtria kurejshite ta kalon hendekun. Kur kërkonte nevoja ne gjuanim me shtiza e gurrë, e poashtu edhe ata e bënin të njëjtën gjë, kështu që unë u godita me shtizë në krahërorë, dhe pësova gjakderdhje të tepërt, ngase vena më ishte këputur. Për shërim, më bartën te tenda e xhamisë. Obligimet e Muhammedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në këtë gjendje lufte, nuk e penguan atë, që herë pas herë të më vizitojë.

Për mua kujdesej një motër muslimane, të cilën e quanin Kefide El-Ensariju. I shtrirë e luta Zotin e Madhëruar: "O Zot, më lejo të jetoj në këtë luftë, se nuk ka popull që dua t'i luftoj më shumë, se sa kurejshite. Ata e kanë mashtruar dhe dëbuar Pejgamberin tënd. Kjo që më ka ndodhë, le të jetë rrugë për në Xhennet. O Zot i Madhëruar, më lejo të jetoj sa të shoh se çdo të ndodhë me Beni Kurejdhen."

All-llahu i Madhëruar pranoi lutjen time. Së pari qërova hesapet me Beni Kurejdhasit, e pastaj nga plagët e rënda ndërrova jetë si shehid.

A e dini si ndodhi kjo?

Pabesimtarët e kishin të qartë se më nuk mund ta mbajnë Medinen të rrethuar, e që pastaj të hynë brenda në qytet. Një tmerr i madh ua kishte dobësuar moralin ushtarak! Zoti i Madhëruar dërgoi një furtunë, sa që ua rrëzoi të gjitha tentat, e nuk mund të shihnin asgjë nga rëra që ua kishte verbuar sytë dhe mbushur gojë. Nuk u mbeti tjetër, përveç se të kthehen prej nga edhe kishin ardhur. Ashtu e ka kjo. Zoti i Madhëruar gjithmonë i ndihmon besimtarët, kurse tradhëtitë u kthehen pabesimtarëve, edhe pse ata mendonin se do të korrin sukses nëse i mbajnë muslimanët të rrethuar.

Pas një muaj rrethimi, ata u kthyen për në Mekke.

All-llahu në Kur'an thotë: **"O ju që keni besuar, përkujtonie të mirën e All-llahut ndaj jush, kur juve ju erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk i shihnit, e All-llahu e shihte atë që ju vepronit."** (Ahzab: 9)

Pas kësaj beteje, Muhammedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e pa të domosdoshme t'i dënojë çifutët, sepse ata e tradhëtuuan aktin e paqes, por edhe t'i mësojë se nuk mundën të tallen me muslimanët si të donë. Prandaj urdhëroi shokët e tij që t'i rrethojnë. Ashtu të rrethuar i mbajtën njëzet e pesë ditë, kur dhe u dorëzuan. Kërkuan nga Muhammedi sal-lallahu alejhi ve sel-

lem që unë të gjykoj, dhe se do ta pranojnë gjykimin tim.

Këto ishin fjalët e fundit që i dëgjova, kurse fytyra e tij që gjëja e fundit që e pashë në këtë botë.

A e dini tash kush jam unë?

Unë jam Sead ibën Muadhi. Muhammedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem e kishte parë nënën time duke vajtuar, dhe kishte thënë: *"Çdo grua që vajton është gënjeshtarë, përveç nënës së Seadit."*

Ndërsa Seid ibën El Huderij thotë: "Mora pjesë në përgatitjen e varrit të Seadit, e çdo pjesë, çdo faqe e dheut që groponim, kishte aromën e miskut."

Një ditë, Muhammedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem i kishin dhuruar një petk prej mëndafshi, e kur pa as'habëve u pëlqen shumë tha: *"A ju pëlqen ky petk?"* Mandej vazhdoi duke thënë: *"Ta dini se faculetat e Seadit në Xhennet janë më të mira."*

Ndoshta do ta pyetni veten se si e kam arritur këtë?

U them se kam pasur iman të sinqertë në All-llahun dhe Pejgamberin e Tij. Çdo gjë që e mësoja nga Muhammedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e praktikojta.

Çdo gjë që pata (jetën dhe pasurinë) ia fala fesë Islame.

Marrë nga libri: **"A e di kush jam unë?"** të autorit Muhammed Hamza SA'DAVI, botuar nga shtëpia botuese **"Furkan ISM"**

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohej hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare  
**Klubi Studentor**

e-mail: penastudentore@hotmail.com



## A e di kush jam unë?



# KUR VDIQA UNË, U DRIDH ARSHI I ZOTIT TË MADHËRUAR